



Mos të të mashtrojnë mediet e tyre!

Më ka pëlqyer replika e një Gjermani që ishte konvertuar në Islam, i cili kur u pyet për terrorizmin dhe lidhjen e tij me Islamin tha:

Kush e nisi Luftën e Parë Botërore, muslimanët?!

Kush e nisi Luftën e Dytë Botërore, muslimanët?!

Kush i vrau 20 milionë njerëz të pafajshëm nga banorët vendës të Australisë, muslimanët?!

Kush e dërgoi bombën atomike në Hiroshima dhe Nagasaki, muslimanët?!

Kush i vrau më tepër se 100 milionë indianë të kuq në Amerikën Veriore, muslimanët?!

Kush i vrau më tepër se 50 milionë indianë të kuq në Amerikën Jugore, muslimanët?!

Kush robëroi rreth 180 milionë afrikanë kur 88% prej tyre vdiqën dhe më pas u hodhën në oqeanin atlantik, muslimanët?!

Jo, kurrsesi nuk kanë qenë muslimanët!

Para gjithë kësaj duhet ta definosh mirë kuptimin e ekstremizmit, pse kur jomuslimanët bëjnë një vepër të gabuar ajo mbetet vetëm një krim, ndërsa kur gabojnë muslimanët ajo quhet ekstremizëm?!

Ki kujdes! Mos e pesho të njëjtën gjë me dy peshore!!!

Përktheu: Hoxhë Valdet Kamberi